



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite Ministry of
Labour and Social Welfare*

INSPEKTORATI I PUNËS

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L – 149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 18, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karriere të Nëpunësve Civilë, duke marr parasysh Rregulloren nr.15/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Inspektoratin e Punës, Inspektorati i Punës shpallë :

Konkurs i Brendshem

Titulli i vendit të punës: Inspektor i Punës – 1 pozite

Referenca :

Koeficienti : 8 (tetë),

Kategoria funksionale: Niveli Profesional

Akt Emërimi: Sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

I përgjegjjet : Udhëheqësit të Divizionit të Koordinimeve

Vendi : Kosovë

Qëllimi i vendit të punës :

Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve që bien në mandat të Inspektorit të Punës.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

Detyra,1: Inspektori i punës kontrollon në mënyrë unike të gjitha vendet e punës që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës si dhe sigurinë dhe shëndetin në punë.

Detyra,2: Jep vërejtje me shkrim për parregullsi ose shqipton gjobën me vendim në shkallën e parë;

Detyra,3: Sigurojnë informacione dhe këshilla për zbatimin e dispozitave të aplikueshme, me të cilat rregullohet marrëdhënia e punës si dhe siguria dhe shëndeti në punë.

Detyra,4 Bëjnë kontrollimin e të gjitha librave të punëdhënësve që duhet t'i mbajnë ata në pajtim me legjislacionin në fuqi,

Detyra,5: Bënë inspektimin e vendit të punës ku është shkaktuar lëndimi i rëndë ose vdekja e një apo më shumë punëtorëve ose ka ndodhë ndryshim në procesin e punës i cili ka rrezikuar jetën e punëtorëve.

Detyra,6: Inspekton vendet e punës dhe vepron në ndalimin e të gjitha llojeve të diskriminimit,

Detyra,7: Urdhëron ndalimin e prodhimit ose procesin e punës aty ku ka fakte të pamohueshme dhe të verifikurara se kushtet në vendin e punës paraqesin rrezik të drejtpërdrejt për jetën, shëndetin apo sigurinë e palëve në vendin e punës

Detyra,8: Urdhëron ndalimin e punës në rastin kur punëdhënësi nuk posedon lejen e punës

Detyra,9: Ruajtjen në konfidencë të plotë burimin e ndonjë ankese që atyre u është paraqitur në lidhje me ndonjë veprim që ka të bëjë me shkeljen e ligjit

Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathhtësitë tjera :

Diplomë universitare të fakultetit juridik, shkencat teknike. Përvojë pune 3 vjeçare. Të njoh punën me kompjuter. Të njoh shkëlqyeshëm gjuhën shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar, kërkesat e dëshirueshme të njoh gjuhën angleze.

Shënim: Procedura e konkurrimit është e hapur për të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Inspektorati i Punës ofron mundësi të barabarta dhe pa diskriminim. Rekrutimi dhe Përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil si dhe legjislacionin tjetër të fuqi.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve : IP/ Zyra e arkivës, Rr.“Qamil Hoxha“

Për informata më të hollshme mund të kontaktoni zyrën e Arkivit të IP-së tel.038/213-369 ose 200 26 138 prej orës 08:00 – 16:00

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit, duke filluar nga data **11.10.2018** deri më datën **18.10.2018 deri në ora 16:00** që konsiderohet ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim ndërsa aplikacionet që arrijnë pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës.